



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/24

Datë: 17.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 36, paragrafit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, nr. 2200, e datës 11.04.2014, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Për fillimin e aplikimit të pagesës prej 0.5% për përvojën e punës së punëtorëve të arsimit.
2. Obligohen Komunitat, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Mjetet për pagesë të pikës 1. sigurohen:
  - 0.3% vazhdojnë të paguhet nga buxhetet e komunave ashtu si janë planifikuar në buxhetin e vitit 2015,
  - Kursimet në Organizata buxhetore dhe
  - Kontigjenca për paga për përvojën e punës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- të gjitha komunave
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/24

Datë: 17.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjetet financiare në vlerë prej 2,648,448.68 euro për mbulim të shpenzimeve të eksproprijimit të tokave të ANP "Adem Jashari"- Kontrolli Ajror Sh.A.
2. Mjete nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga nën programi Zyra për Shpronësim (210-605), kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, konkretisht nga projekti "Shpronësimet" kodi-13130, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, ANP "Adem Jashari"-Kontrolli Ajror Sh.A. dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/24

Datë: 17.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Osman Shahini, emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Diasporës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/24

Datë: 17.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Znj. Refike Sylçevci, emërohet Drejtoreshë e Përgjithshme në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.
2. Mandati i të emëruares nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. E emëruara nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/24

Datë: 17.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 prill 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Këshilli"), i cili kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.
2. Këshilli përbëhet nga:
  - 2.1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Koordinatore e Këshillit;
  - 2.2. Ministria e Financave;
  - 2.3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
  - 2.4. Ministria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
  - 2.5. Ministria e Drejtësisë;
  - 2.6. Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale;
  - 2.7. Ministria e Infrastrukturës;
  - 2.8. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
  - 2.9. Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor;
  - 2.10. Ministria e Diasporës;
  - 2.11. Oda Ekonomike e Kosovës;
  - 2.12. Aleanca Kosovare e Biznesit;
  - 2.13. Oda Amerikane në Kosovë, dhe
  - 2.14. Asociacioni i Komunave të Kosovës.
3. Këshilli ka fushëveprimtari që të:
  - 3.1. Inicijoj dhe harmonizoj aktivitetet ndërinstitucionale në drejtim të implementimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe projekteve zhvillimore, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.
  - 3.2. Organizoj dha harmonizoj aktivitetet e institucioneve shtetërore në përmirësimin e ambientit për biznes dhe investime në Republikën e Kosovës me qëllim të eliminimit të barrierave dhe adresimit të sfidave të bërit biznes në Republikën e Kosovës.

- 3.3. Inicijoj akte ligjore dhe nënligjore, pranë Qeverisë së Republikës së Kosovës, të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e ambientit për biznes, si dhe analizoj legjislacionin ekzistues dhe nevojat për përmirësim.
  - 3.4. Miratoj plane operative për përmirësimin e ambientit për biznes dhe investime.
  - 3.5. Inicijoj biseda dhe bashkëpunim me investitorët potencial strategjik.
  - 3.6. Prezantoj pranë Qeverisë raportet mbi realizimin e planit operativ për ambientin për biznes.
  - 3.7. Bashkëpunoj me organizata dhe institucione ndërkombëtare në shkëmbim të përvojave dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e mjedisit biznesor.
  - 3.8. Përgatis analiza për mundësitë zhvillimore dhe përparësitë krahasuese të Kosovës.
  - 3.9. Përkrahë fuqizimin e komunitetit të biznesit në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit.
  - 3.10. Koordinoj dhe monitoroj implementimin e planit të veprimit për implementimin e vizionit të zhvillimit ekonomik.
4. Sipas nevojës dhe rrethanave, Këshilli mund të thërras në takim edhe Ministri dhe organe tjera qeveritare dhe përfaqësues të grupeve të interesit.
  5. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të përgatisë Rregulloren e Punës për Funkcionalizim të Këshillit.
  6. Punët administrative dhe teknike të Këshillit i kryen Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
  7. Ky vendim shfuqizon Vendimin e Qeverisë nr. 02/67 të datës 21.03.2012, Vendimin nr. 12/78 të datës 12.06.2012 dhe Vendimin nr.20/109 të datës 19.12.2012.
  8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë